

**AGJENCIA E OFRIMIT TE SHËRBIMEVE
PUBLIKE TE INTEGRUARA (ADISA)**

**Rikonstruksioni i Qendrës së Shërbimeve Publike të
Integruara me një ndalesë Fier**

PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR - CHECKLIST

PRILL 2016

PËRMBAJTJA

- A) INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PROJEKTIN DHE VENDNDODHJEN**
- B) INFORMACION MBI SIGURINË**
- C) MASAT ZBUTESE**

A) INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PROJEKTIN DHE VENDNDODHJEN

INFORMACION INSTITUCIONAL DHE ADMINISTRATIV			
Vendi	Shqipëri		
Titulli i projektit	Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin Rikonstruksioni i Qendrës së Shërbimeve Publike të Integruara me një ndalesë Fier		
Qëllimi i projektit dhe aktiviteti	Punimet do të kryhen në një objekt ekzistues dhe nuk do të shtrihen mbi perimetrin ekzistues të territorit. Punimet do të përfshijnë rikonstruksione të vogla.		
Marrëveshje institucionale	ADISA	PMU Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike	Bashkia Fier
PERSHKRIMI I VENDNDODHJES			
Emri i vendndodhjes	Rr. "Ramiz Arjanitasi", Ish Shtëpia e Oficerave, kati i 1-rë, rreth 396 metra katrorë.		
Pronari i tokës?	Qeveria Shqiptare	Bashkëlidhur 1: <input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	
Përshkrimi gjeografik, fizik, biologjik, gjeologjik, hidrografik, dhe konteksti socio-ekonomik.	Ish Shtëpia e Oficerave është një objekt i ndërtuar në regjimin komunist dhe është përdorur për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes të asaj kohe. Objekti ndodhet në një zonë qendrore të qytetit dhe rrethohet nga ndërtesa të tjera publike si Teatri "Bylis". Objekti ndodhet në një zonë trafiku mesatarisht të rëndë.		
Vendndodhjet, distanca për marrjen e materialeve, veçanërisht agragate, ujë, gurë, etj.	Objekti është i lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë dhe me kanalizimet e qytetit të Kavajës. Punimet do të prokurohen. . Depozitimi i mbetjeve të ngurta do të bëhet në vende të caktuara dhe të miratuara nga Bashkia Fier në momentin që do të merret leja e ndërtimit.		
LEGJISLACIONI			
Identifikimi i legjislacionit, lejeve kombëtare dhe lokale që zbatohen për aktivitetin e projektit	Bazuar në legjislacionin e ri për planifikimin urban, pjesë e dokumentacionit për lejet dhe licencat e ndërtimit është vlerësimi dhe impakti mjedisor i projektit nga ekspertë të licensuar. Klienti duhet të marrë masa që të gjitha klauzolat e lejes mjedisore të përmbushen para fillimit të punimeve.		
KONSULTIMI PUBLIK			
Kur dhe ku duhet të mbahen konsultimet publike	Vendimi u diskutua në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në Komisionet parlamentare përkatëse, në Këshillin bashkiak. Vendimi i marrë është publikuar <i>online</i> për publikun e gjerë.		
NDERTIM KAPACITETESH INSTITUCIONALE			
A do të ketë ndërtim kapacitetesh?	<input checked="" type="checkbox"/> Jo ose <input type="checkbox"/> Po		

B) INFORMACION MBI SIGURINË

IMPAKTI SOCIAL DHE MJEDISOR			
	Aktiviteti	Statusi	Aktivitetet e synuara
A do të përfshijnë punimet në kantier ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme?	A. Rikonstruksioni i ndërtesës	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit A si më poshtë
	B. Ndërtim i ri i pjesshëm	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit A si më poshtë
	C. Sistem trajtimi individual të ujërave të ndotura	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit B si më poshtë
	D. Ndërtesë(at) historike dhe rrethet	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit C si më poshtë
	E. Blerja e tokës ¹	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit D si më poshtë
	F. Materiale të rrezikshme ose toksike ²	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit E si më poshtë
	G. Ndikimet në pyje dhe/ose në zonat e mbrojtura	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit F si më poshtë
	H. Trajtimi/ manaxhimi i mbetjeve mjekësore	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit G si më poshtë
	I. Trafiku dhe siguria e këmbësorëve	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo	Referoju aktivitetit H si më poshtë

¹ Përvetësimi i tokës përfshin zhvendosjen e njerëzve, ndryshimin e mënyrës së jetesës në pronën private lidhur me token që po blihet/ transferohet dhe prek njerëzit që jetojnë, si dhe/ ose zhvillon aktivitetin një biznes (kioska).

² Materialet toksike/ të rrezikshme përfshijnë por nuk kufizohen në azbest, ngjyra toksike, tretës të dëmshëm dhe heqjen e bojës së plumbit, etj.

C) MASAT ZBUTËSE

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E MASAVE ZBUTËSE PER T'U PLOTESUAR
0. Kushtet e përgjithshme	Njoftimi dhe siguria e punonjësit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Inspektoratet vendore të ndërtimit dhe mjedisit, si dhe komuniteti janë njoftuar për punimet që do të kryhen; (b) Publiku është njoftuar për punimet përmes njoftimit në media dhe/ose në vende të hapura për publikun (përfshirë kantierin e punimeve); (c) Janë marrë të gjitha lejet e kërkuara me ligj për ndërtim dhe/ose rikonstruksion; (d) Të gjitha punimet duhet të kryhen në mënyrë të sigurt për të minimizuar ndikimet mbi njerëzit dhe mjedisin; (e) Pajisjet mbrojtëse personale të punëtorëve duhet të jenë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare (gjithmonë kaskë mbrojtëse, maska, syze sigurie sipas nevojës, rrip sigurimi dhe çizme); (f) Punëtorët do të informohen nëpërmjet një tablele sinjalizuese, e përshtatshme për kantieret, lidhur me rregullat kryesore dhe rregulloret që duhen zbatuar; (g) Përfshirja e punëdhënësit; (h) Procedura të sakta për projektimin dhe sigurinë; (i) Largimi i rregullt i mbetjeve.
A. Aktivitetet e përgjithshme të ndërtimit dhe rehabilitimit	Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Të evitohet ngritja e pluhurit gjatë shembjes së pjesëve të brendshme (shpim pneumatik/ shembje e mureve), nëpërmjet spërkatjes të vazhdueshme me ujë dhe/ose vendosjes së rrjetave mbrojtëse nga pluhuri; (b) Të grumbullohen mbetjet e krijuara nga shembja e mureve në vende të kontrolluara dhe të spërkatën me ujë për të reduktuar pluhurin e mbetjeve; (c) Të mos ketë mbeturina dhe mbetje të ngurta(dhera) në mjedisin rrethues për të minimizuar pluhurin; (d) Nuk duhet të ketë djegie në mjedis të hapur të materialeve të ndërtimit/mbetjeve në kantier; (e) Nuk duhet të ketë qëndrim të tepruar të mjeteve të ndërtimit në kantier.
	Mjedisi akustik	<ul style="list-style-type: none"> (a) Zhurmat duhet të kufizohen sipas orareve të lejuara në lejen e ndërtimit; (b) Të përdoren metodat dhe pajisjet e duhura për ndërtim në zonën e banuar; (c) Gjatë punimeve motorët e gjeneratorëve, kompresorët e ajrit dhe pajisje të tjera motorike duhet të jenë të mbyllura, si dhe pajisjet duhen të vendosen sa më larg të jetë e mundur nga zonat e banuara.
	Cilësia e ujit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Të merren masat e nevojshme për kontrollin e erozionit dhe të sedimenteve në kantierin e ndërtimit, si p.sh. paleta dhe/ose rrjeta për mbrojtjen nga pluhuri për të parandaluar lëvizjen e sedimenteve dhe shkaktimin e turbullirave të tepërta në prurjet e ujit.
	Manaxhimi i mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> (a) Të identifikohet vend-grumbullimi dhe largimi i mbetjeve për të gjitha llojet e mbetjeve që do të krijohen nga punimet; (b) Mbetjet e ngurta të grumbullohen dhe depozitohen në përputhje me Legjislacionin Mjedisor të RSH-së; (c) Të dhënat për depozitim e mbetjeve të mbahen si provë për manaxhimin e duhur sipas projektimit; (d) Kontraktori të ripërdorë dhe riciklojë materialet e përshtatshme sa herë të jetë e nevojshme (me përjashtim të azbestit).
B. Sistemi i trajtimit të ujërave të zeza	Cilësia e ujit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Mënyra sesi do të trajtohen ujërat e zeza nga kantieret e ndërtimit (instalimi ose rikonstruksioni) duhet të miratohet nga autoritetet vendore; (b) Para shkarkimit të tyre, mbetjet e krijuara nga sistemet e ujërave të zeza duhet të trajtohen në mënyrë që të përmbushin kriteret minimale të cilësisë, në përputhje me udhëzimet kombëtare mbi cilësinë e mbetjeve ujore dhe mbi trajtimin e ujërave të zeza. (c) Mjetet e ndërtimit dhe makineritë të lahen vetëm në zonat e caktuara që të mos ndoten sipërfaqet ujore.
C. Ndërtës(a) historike	Trashëgimia kulturore	<ul style="list-style-type: none"> (a) Duhet të bëhet njoftimi dhe të merren miratimet/lejet nga autoritetet lokale nëse ndërtesa është një strukturë me rëndësi historike, shumë afër një strukturë të tillë, ose e vendosur në një zonë të caktuar historike, si dhe të gjitha punimet e planifikuara të kryhen në përputhje me legjislacioni kombëtar dhe vendor. (b) Të merren masat që veprat e artit ose "zbulime të rastit" që bëhen gjatë gërmimeve ose ndërtimit, të regjistrohen, të kontaktohen zyrtarët përgjegjës dhe të pezullohen punimet ose të modifikohen në rast të zbulimeve të tilla.

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E MASAVE ZBUTESE PER T'U PLOTESUAR
D. Marrja e truallit	Plani/kuadri i marrjes së truallit	<p>(a) Duhet të konsultohet menjëherë përgjegjësi i Ekipit të Punës të Bankës nëse shpronësimi i tokës nuk është parashikuar por kërkohet, ose nëse nuk është parashikuar por mund të ndodhë që përdoruesi ligjor ose joligjor i tokës humbet mundësinë e të ardhurave;</p> <p>(b) Të zbatohet miratimi i planit/kuadrit të marrjes së truallit (nëse kërkohet nga projekti).</p>
E. Materialet toksike	Manaxhimi i azbestit	<p>(a) Nëse ka azbest në kantier, duhet të shënohet qartësisht si material i rrezikshëm;</p> <p>(b) Kur është e mundur, azbesti duhet të ruhet dhe të izolohet siç duhet për të minimizuar ekspozimin;</p> <p>(c) Para largimit (nëse largimi është i nevojshëm), azbesti duhet të trajtohet me një agjent të lagësht për të minimizuar pluhurin;</p> <p>(d) Azbesti duhet të trajtohet dhe të depozitohet nga profesionistë të aftë dhe me përvojë;</p> <p>(e) Nëse materiali i azbestit depozitohet përkohësisht, mbetjet duhen të mbyllën në mënyrë të sigurt brenda kontenierëve të mbyllur dhe të markuar. Duhet të merren masa sigurie kundër largimit të paautorizuar nga vendi;</p> <p>(f) Azbesti i hequr nuk do të ripërdoret.</p>
	Manaxhimi i mbetjeve të rrezikshme/ toksike	<p>(a) Ruajtja e përkohshme e të gjitha substancave të rrezikshme ose toksike në kantier do të kryhet në kontenierë të sigurtë, të etiketuar me informacion mbi përbërjen, cilësinë dhe përdorimin;</p> <p>(b) Kontenierët me substanca të rrezikshme duhet të vendosen brenda një kontenieri hermetik për të parandaluar derdhjen dhe rrjedhjen;</p> <p>(c) Mbetjet do të transportohen me mjete të licencuara të posaçme dhe do të depozitohen në një vend të licencuar;</p> <p>(d) Nuk duhet të përdoren bojra me përbërës toksikë, tretës ose ngjyra me bazë plumbi.</p>
F. Pyjet, zonat e lagështa dhe/ose zonat e mbrojtura të prekura	Mbrojtja	<p>(a) Të gjitha habitatet natyrore të njohura dhe zonat e mbrojtura në afërsi të aktivitetit nuk do të dëmtohen apo të shfrytëzohen. Ndalohet rreptësisht për gjithë stafin gjuetia, kullotja, prerjet ose aktivitete të tjera të dëmshme;</p> <p>(b) Zonat e lagështa dhe përrënjtë në afërsi duhet të jenë të mbrojtura nga prurjet e krijuara në shesh ndërtim, me funksionet e duhura për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve duke përfshirë, por jo vetëm paletat e barit dhe rrethimet me baltë;</p> <p>(c) Nuk duhet të ketë gropa të palicencuara, gurore apo hedhje të mbetjeve në zonat e afërta, dhe veçanërisht jo në zonat e mbrojtura.</p>
G. Depozitimi i mbeturinave mjekësore	Infrastruktura për manaxhimin e mbetjeve mjekësore	<p>(a) Kontraktuesi duhet të sigurojë që objektet e kujdesit shëndetësor të sapo ndërtuara dhe/ose të rikonstruara të përfshijnë infrastrukturën e nevojshme për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve mjekësore në përputhje me rregulloret kombëtare; kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pajisjet e veçanta për mbetjet e veçanta të kujdesit shëndetësor (duke përfshirë instrumenta të "mprehta" të ndotura, si dhe inde njerëzore ose lëngje) nga mbetje të tjera; ▪ Krijimi i pajisje të posaçme për ruajtjen e mbetjeve mjekësore; dhe ▪ Duhet të aplikohen mënyra të përshtatshme dhe operacionale depozitimi, nëse veprimtaria përfshin trajtim në mjedis.
H Trafiku dhe siguria këmbësorëve	Rreziqet direkte ose indirekte nga punimet për trafikun publik dhe këmbësorët	<p>(b) Kontraktuesi duhet të sigurojë që shesh ndërtimi të jetë i sigurt dhe të sigurojë koordinim të trafikut me ndërtimin në përputhje me rregulloret kombëtare. Kjo përfshin, por nuk kufizohet tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Tabelat sinjalizuese, shenjat paralajmëruese, pengesat dhe shmangiet e trafikut: kantieri duhet të jetë qartësisht i dukshëm dhe publiku të paralajmërohet për të gjitha rreziqet e mundshme; ▪ Sistemi i menaxhimit të trafikut dhe trajnimi i stafit sidomos për hyrjen në kantier, si dhe të trafikut të rënduar në afërsi të kantierit. Sigurimi i kalimeve të sigurta dhe vendkalimet për këmbësorë, aty ku ka punime. ▪ Rakordimi i orareve të punës me trafikun lokal, p.sh. shmangia e transportit gjatë orëve të pikut apo gjatë kohës së lëvizjes të bagëtime; ▪ Manaxhimi aktiv i trafikut nga staf i trajnuar në kantier nëse nevojitet kalim i sigurt për publikun; ▪ Sigurimi i aksesit të vazhdueshëm dhe të sigurt tek zyrat, dyqanet dhe rezidenat gjatë rikonstrksionit, nëse ndërtesat janë të hapura për publikun.

I. Supervizimi i punimeve në kantier	Mbrojtja e mjedisit natyror dhe biodiversitetit	<ul style="list-style-type: none"> (a) Minimizimi i prezencës së stafit dhe trafikut të automjeteve; (b) Përdorimi i rrugëve ekzistuese dhe të pashtuara sa më shumë të jetë e mundur; (c) Heqja e të gjitha mbetjeve pas përfundimit të punimeve; (d) Kalimi i sigurt për stafin dhe kalimtarët duke siguruar zonat e punës, si dhe kufizimi i kalimit gjatë punimeve me rrezikshmëri (p.sh. gjatë përdorimit të lëndëve plasëse për hetimet sizmike).
--------------------------------------	-------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

EKZISTENCA E NJE PLANI I MONITORIMI MJEDISOR?	PO
PERGJEGJES PER MONITORIMIN	KONTRAKTORI